<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Agjencia e Kosovës për Standarde dhe Vlerësim</b></p> <p>1. Qeveria me propozimin e Ministrit themelon Agjencinë e Kosovës për Standarde dhe Vlerësim</p> <p>2. AKSV është përgjegjëse për:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Organizimin e provimeve shtetërore për profesionet e rregulluara;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Publikimin dhe certifikimin e rezultateve të provimeve shtetërore;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Zhvillimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave të kandidatëve të cilët iu kanë nënshtruar provimit shtetëror.</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Struktura dhe funksionimi i AKSV-së rregullohet me akt nënligjor nxjerr nga MASHT.</p> <p>3. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Kosova Agency for Standards and Assessment</b></p> <p>1. The government establishes the Kosova Agency for Standards and Assessment with the proposal of the Minister.</p> <p>2. The KASA is responsible for the:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Organization of the state exams for the specified regulated occupations;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Publication and certification of state exam results;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Development and updating of a data base of candidates, which are subject to the state exam.</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. The structure and function of the KASA is regulated with sub-legal act issued by MEST.</p> <p>3. Appointment, discharge, function and responsibilities of the Executive Chief Officer are regulated with relevant provisions in force in the Republic of Kosova.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Kosovska agencija za standarde i procenjivanje (KASP)</b></p> <p>1. Vlada na predlog Ministra osniva Kosovsku agenciju za standarde i procenjivanje (KASP).</p> <p>2. KASP je odgovorna za:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Organizovanje državnih ispita za regulisane profesije;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Objavljivanje i sertifikovanje rezultata državnih ispita;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Razvoj i ažuriranje baze podataka za kandidate koji se povrgavaju državnom ispitu.</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Struktura i funkcionisanje KASP-a se reguliše podzakonskim aktom izdatih od strane MONT-a.</p> <p>3. Imenovanje, razrešenje, funkcije i odgovornosti izvršnog šefa uređuje se dotičnim odredbama na snazi u Republici Kosovo</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Provimi shtetëror</b></p> <p>1. Provimi shtetëror:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>The state exam</b></p> <p>1. The state exam:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Državni ispit</b></p> <p>1. Državni ispit:</p>

<p>1.1. Ofron garanci publike për aftësitë të cilat janë themelore për ushtrimi e një profesioni të rregulluar;</p> <p>1.2. Kryen testimin e njohurive përkatëse të çdo kandidati që synon të ushtroj një profesion të rregulluar, duke siguruar njëtrajtshmëri dhe transparencë në vlerësimin dhe kualifikimin e kandidatëve, në nivel kombëtar, përmes verifikimit të përvetësimit të aftësive të nevojshme profesionale për profesionin e rregulluar.</p> <p>2. Përmbajtja e çdo provimi shtetëror hartohet në përputhje të veçantë me fushën e veprimtarive profesionale.</p> <p>3. Pas përfundimit me sukses të provimit shtetëror, titulli përkatës profesional dhe licenca iu jepen kandidatit sipas listës së profesioneve në Kosovë.</p> <p>4. Në vijim përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin shtetëror para se të mund të marrin një licencë për të ushtruar veprimtari në profesionin e tyre të rregulluar:</p> <p>4.1. Profesionistët, të cilët ushtrojnë apo kanë ushtruar një profesion të rregulluar në Kosovë para hyrjes në fuqi të këtij Ligji;</p>	<p>1.1. Provides public guarantees for the skills and capabilities that are basic for practicing a regulated profession;</p> <p>1.2. Conducts testing of the relevant knowledge of any candidate that aspires to practice a regulated profession, by ensuring uniformity and transparency in the evaluation and qualifications of candidates, at the national level, through verification of acquisition of the necessary professional skills for the given regulated profession.</p> <p>2. The content of each state exam is compiled in specific accordance with the field of professional activity.</p> <p>3. After successful completion of the state exam, the relevant professional title and license are given upon the candidate according to the list of professions in Kosova.</p> <p>4. The following are excluded from the obligation to pass the state exam before they can get a license to practice activities in their regulated profession:</p> <p>4.1. The professionals, who practice or have practiced a regulated profession in Kosovo before the entry into force of this Law;</p>	<p>1.1. Realizuje javne garancije o odgovornostima koje donosi bavljenje regulisanom profesijom;</p> <p>1.2. Obavlja testiranje relevantnih znanja svakog kandidata koji teži bavljenju regulisanom profesijom, obezbeđivanjem jednoobraznosti i transparentnosti u procenivanju i kvalifikaciji kandidata, na nacionalnom nivou, kroz veifikaciju stečenih potrebnih profesionalnih veština za regulisane profesije.</p> <p>2. Sadržaj državnog ispita se sastavlja u skladu sa oblašću profesionalne delatnosti.</p> <p>3. Nakon uspešnog polaganja državnog ispita, relevantni profesionalni naziv i licenca se izdaju kandidatu prema listi profesija na Kosovu.</p> <p>4. U nastavku, izuzeti su od obaveze da polažu državni ispit pre nego da mogu da dobiju licencu za obavljanje delatnosti u njihovoj regulisanoj profesiji:</p> <p>4.1. Profesionalci, koji obavljaju ili koji su obavljali regulisanu profesiju na Kosovu pre stupanja na snagu ovog Zakona;</p>
---	--	--

<p>4.2. Profesionistët, të cilët kanë fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar jashtë Republikës së Kosovës, që përcaktohet në akte të veçanta nënligjore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Organizimi i provimit shtetëror</b></p> <p>1. Të gjitha provimet shtetërore për profesione të rregulluara, organizohen dhe zhvillohen nga AKSV, në bashkëpunim me KSHPRr dhe organet tjera kompetente.</p> <p>2. Komisioni i Provimit Shtetëror për çdo profesion të rregulluar caktohet nga AKSV dhe përbëhet nga katër (4) anëtarë si në vijim:</p> <p>2.1. Një (1) përfaqësues të caktuar nga Ministri;</p> <p>2.2. Një (1) përfaqësues nga AKSV;</p> <p>2.3. Një (1) përfaqësues, i cili është anëtar i organit profesional përkatës;</p> <p>2.4. Një (1) përfaqësues nga personeli akademik i universiteteve, të akredituara për programin përkatës të studimit të profesionit të rregulluar, të cilët kanë</p>	<p>4.2. The professionals, who have earned the right to practice a regulated profession outside the Republic of Kosovo, which is defined in special sub-legal acts.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Organization of the state exam</b></p> <p>1. All state exams for regulated occupations are organized and developed by the KASA, in cooperation with SCRП and other competent bodies.</p> <p>2. The State Examination Commission for each regulated profession is appointed by the KASA and is composed of four (4) members as following:</p> <p>2.1. One (1) representative assigned by the Minister;</p> <p>2.2. One (1) representative of the KASA;</p> <p>2.3. One (1) representative who is a member of the relevant professional body;</p> <p>2.4. One (1) representative from the academic personnel of universities, accredited for the relevant study program of the regulated profession, which have</p>	<p>4.2. Profesionalci, koji su dobili pravo za obavljanje regulisane profesije van Republike Kosovo, što je određeno posebnim podzakonskim aktima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Organizovanje državnog ispita</b></p> <p>1. Svi državni ispiti za regulisane profesije se organizuju i razvijaju od strane KASP-a, u saradnji sa DSRP-om i drugim nadležnim organima.</p> <p>2. Komisija državnog ispita se za svaku regulisanu profesiju određuje od strane KASP-a i sastoji se od četiri (4) članova kao u nastavku:</p> <p>3.1. Jedan (1) predstavnik određen od Ministar;</p> <p>3.2. Jedan (1) predstavnik KASP-a;</p> <p>3.3. Jedan (1) predstavnik koji je član dotičnog profesionalnog organa;</p> <p>3.4. Jedan (1) predstavnika iz akademskog osoblja univerziteta, akreditovana za dotične studijske programe regulisane profesije, koji imaju zvanje</p>
---	---	--



<p>titullin e Profesorit dhe të paktën dhjetë (10) vite përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>3. Anëtarët e përcaktuar në pikat 2.2 dhe 2.3. të paragrafit 2 të këtij neni duhet të emërohen sipas mënyrës në vijim:</p> <p>3.1. Organi profesional përkatës i propozon AKSV-së të paktën dy (2) kandidatë, prej të cilëve duhet të zgjidhet përfaqësuesi i përcaktuar në pikën 2.3. të paragrafit 2 të këtij neni;</p> <p>3.2. Këshilli Shtetëror për Profesione të Rregulluara, i propozon AKSV-së të paktën dy (2) kandidatë, prej të cilëve zgjidhet një (1) përfaqësues siç përcaktohet në pikën 2.4 të paragrafit 2 të këtij neni.</p> <p>4. Në rast se përfaqësimi i organit profesional në Komisionin e Provimit Shtetëror nuk është i mundur, AKSV përfaqësohet me një (1) anëtar shtesë.</p> <p>5. Kryetari i Komisionit të Provimit Shtetëror është përfaqësues siç përcaktohet në pikën 2.1 të paragrafit 2 të këtij neni.</p> <p>6. Kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni,</p>	<p>the title of Professor and at least ten (10) years of professional experience at higher education institutions.</p> <p>3. Members specified in points 2.2 and 2.3. of paragraph 2 of this article shall be appointed in the following way:</p> <p>3.1. The relevant professional body proposes to the KASA at least two (2) candidates, from which to select the member specified in point 2.3 of paragraph 2 of this article;</p> <p>3.2. The State Council for Regulated occupations proposes to the KASA, at least two (2) candidates, from which one (1) representative is selected as specified in point 2.4 of paragraph 2 of this article;</p> <p>4. If representation of the professional body in the State Examination Commission is not possible, the KASA is represented with one (1) additional member.</p> <p>5. The Chairperson of the State Examination Commission is a representative as specified in point 2.1 of paragraph 2 of this article.</p> <p>6. The criteria for selection of representatives determined in paragraph 2 of</p>	<p>profesora, i najmanje deset (10) godina radnog iskustva u institucijama visokog obrazovanja.</p> <p>4. Članovi navedeni u tačkama 2.2. i 2.3. stava 2. ovog člana treba da se imenuju prema dolenavedenom načinu:</p> <p>4.1. Nadležni profesionalni organ predlaže KASP-u najmanje dva (2) kandidata, od kojih se treba birati određeni predstavnik u tački 2.3. stava 2. ovog člana;</p> <p>4.2. Državni savet za regulisane profesije predlaže KASP-u najmanje dva (2) kandidata, od kojih se bira jedan (1) predstavnik kao što je određeno u tački 2.4. stava 2. ovog člana.</p> <p>5. U slučaju da predstavljanje nadležnog organa u Državnoj ispitnoj komisiji nije moguće, KASP je predstavljena jednom (1) dodatnom članom.</p> <p>6. Predsedavajući Državne ispitne komisije je predstavnik određen podstavom 2.1. stava 2. ovog člana.</p> <p>7. Kriterijumi za biranje pomenutih predstavnika koji su određeni u stavu 2. ovog</p>
--	---	---

<p>përcaktohen nga AKSV në bashkëpunim me organin profesional të fushës përkatëse.</p> <p>7. AKSV përcakton rregullat për funksionimin e Komisionit të Provimit Shtetëror, kompensimin e anëtarëve të saj, si dhe procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të provimit shtetëror.</p> <p>8. Temat, mënyrat e zhvillimit dhe menaxhimit përmes teknologjisë digjitale të provimit shtetëror, përcaktohen nga AKSV, pas këshillimeve me Ministrinë.</p>	<p>this article are defined by the KASA, in cooperation with the professional body of the relevant field.</p> <p>7. The KASA defines the rules for the function of the State Examination Commission, the compensation for its members and procedures and manner of development of the state exam.</p> <p>8. Topics, the development and management ways, through digital technology of state exam, are defined by the KASA, after consultation with the Ministry.</p>	<p>člana, određuju se od strane KASP-a u saradnji sa dotičnim nadležnim organom.</p> <p>8. KASP određuje pravila za funkcionisanje Komisije državnog ispita, nadoknadu za svoje članove, kao i procedure i način razvoja državnog ispita.</p> <p>9. Teme, načini razvoja i upravljanja, preko digitalne tehnologije državnog ispita su određene podzakonskim aktom ministra KASP-a, nakon savetovanja sa Ministarstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Praktika profesionale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>The professional practice</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Profesionalna praksa</b></p>
<p>1. Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit, me anë të mekanizmave të përcaktuar nga AKSV-ja, sipas propozimeve nga organi profesional përkatës.</p> <p>2. Praktika profesionale zhvillohet nën drejtimin e një profesionisti, personi fizik apo juridik.</p> <p>3. Organi profesional përkatës, përmes strukturave të veta, siguron që aftësimi</p>	<p>1. The professional practice aims effective acquisition of technical, practical and ethical knowledge of a profession, by mechanisms that are defined by KASA, based upon proposals from the relevant professional body.</p> <p>2. The professional practice is developed under the direction of a professional, physical or legal person.</p> <p>3. The relevant professional body, through its structures, ensures that practical training in a</p>	<p>1. Profesionalna praksa ima za cilj efektivno usavršavanje tehničkih znanja, profesionalnih praktičnih i etičkih znanja, mehanizmima koje određuje KASP prema predlozima iz relevantnog profesionalnog organa.</p> <p>2. Profesionalna praksa se razvija pod upravom profesionalca, fizičkog ili pravnog lica.</p> <p>3. Određeni nadležni organ, preko svojih struktura, osigurava da se praktično</p>

<p>praktik në një profesion të rregulluar kryhet nën drejtimin e një profesionisti me përvojë, me të pakën tre (3) vite të përvojës përkatëse dhe që ofron garanci të mjaftueshme për përgatitjen teorike dhe praktike të praktikantit.</p> <p>4. Gjatë realizimit të praktikës profesionale, praktikantit i jepet një kompensim, siç përcaktohet nga institucioni/organizata ku mbahet praktika profesionale.</p> <p>5. Kompensime apo shpërblime të ngjashme të vlerësimit jepen nga institucioni/organizata ku mbahet praktika profesionale.</p> <p>6. Pas përfundimit të suksesshëm të praktikës profesionale, çdo personi i bëhet me dije se ka përmbushur detyrimin për praktikë profesionale, që dëshmon se në një periudhë të caktuar dhe në përputhje me kriteret specifike të profesionit të rregulluar, ka qenë i angazhuar në një veprimtari profesionale, brenda ose jashtë vendit, e cili i ka dhënë mundësi të përvetësojë praktikë të mjaftueshme profesionale në fushën e këtij profesioni.</p> <p>7. AKSV, në bashkëpunim me organin profesional përkatës, përcakton si vlerësohet nëse përvoja profesionale e kandidatit është e</p>	<p>regulated profession is conducted under the direction of an experienced professional, with at least three (3) years of relevant experiences and providing a sufficient guarantee for theoretical and practical preparation of the practice trainee.</p> <p>4. During the realization of the professional practice, compensation is given to trainee, as defined by the institution/organization, where the professional practice is carried.</p> <p>5. Compensations or similar evaluation rewards are given by the institution/organization, where the professional practice is carried.</p> <p>6. Upon successful completion of their professional practice, each person is noted to have fulfilled the obligation for professional practice, which proves that in a certain period and in compliance with specific criteria of the regulated profession, has been engaged in a professional activity, inside or outside the country, which has given an opportunity to acquire a sufficient professional practice in this profession.</p> <p>7. The KASA, in cooperation with the relevant professional body, determines how to evaluate whether the professional experience</p>	<p>osposobljavanje u profesiji vrši pod upravljanjem iskusnog profesionalca, sa najmanje tri (3) godine relevantnog iskustva i koji obezbeđuje dovoljno garancija za tehničko i praktično pripremanje pripravnika.</p> <p>4. Tokom realizacije profesionalne prakse, pripravniku se daje naknada koja se određuje od strane institucije/organizacije u kojoj se održava profesionalna praksa.</p> <p>5. Naknade ili slične nagrade procene se daju od strane institucije/organizacije gde se održava profesionalna praksa.</p> <p>6. Nakon uspešno završene profesionalne prakse, svakom pojedincu se daje doznanja da je ispunio svoju obavezu profesionalne prakse, što dokazuje da u jedan vremenski period i u skladu sa specifičnim kriterijumima regulisane profesije, da je bio angažovan u profesionalnoj delatnosti, unutar ili van zemlje, koja mu je dala mogućnost da usavrši dovoljno profesionalno iskustvo u oblasti ove profesije.</p> <p>7. KASP u saradnji sa nadležnim profesionalnim organom određuje kako se procenjuje ukoliko profesionalno iskustvo</p>
---	--	---

<p>mjaftueshme për ta përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Anëtarësimi në organin profesional përkatës</b></p> <p>Çdo profesionist, me qëllim që të fitoj të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, duhet të anëtarësohet në organin profesional përkatës.</p>	<p>of the candidate is sufficient to exclude him/her from liability for the performance of professional practice.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Membership in the relevant professional body</b></p> <p>Each professional, in order to earn the right of practicing a regulated profession, must join the relevant professional body.</p>	<p>kandidata je dovoljno za isključivanje obaveze za obavljanje profesionalne prakse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Članstvo u nadležnom profesionalnom organu</b></p> <p>Svaki profesionalac, da bi dobio pravo bavljanja regulisanom profesijom, treba da se učlani u dotični nadležni organ.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Përgjegjësia e Ministrisë</b></p> <p>1. Ministria me propozimin e KSHPRr përcakton:</p> <p>1.1. Kërkesat minimale për kualifikimet profesionale për profesionet e rregulluara;</p> <p>1.2. Listën e kualifikimeve dhe nën-kualifikimeve të tyre për profesionet e rregulluara;</p> <p>1.3. Ministri është përgjegjës për lëshimin e licencës, përveç rasteve kur kjo përgjegjësi i delegohet ndonjë organi</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Responsibility of the Ministry</b></p> <p>1. The Ministry with the proposal from the SCRO defines:</p> <p>1.1. The minimum requirements for professional qualifications of the regulated occupations;</p> <p>1.2. The list of their qualifications and sub-qualifications on the regulated occupations;</p> <p>1.3. The Minister is responsible for issuing licenses, unless this responsibility has been delegated to a specific professional</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Odgovornos Ministarstva</b></p> <p>1. Ministarstvo, na predlog NSRP-a, određuje:</p> <p>1.1. Minimalne zahteve za profesionalnu kvalifikaciju za regulisane profesije;</p> <p>1.2. Lista njihovih kvalifikacija i podkvalifikacija za regulisane profesije;</p> <p>1.3. Ministar je odgovoran za izdavanje licence, osim u slučajevima kada se ova odgovornost delegira nekom organu ili</p>

<p>apo shoqate profesionale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Organi kompetent për zhvillimin e standardeve të profesionit</b></p> <p>1. Misioni i organit kompetent është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të rregulluar, si dhe mbrojtja e publikut nga kequshtrimi i profesionit.</p> <p>2. Organi kompetent për zhvillimin e standardeve të profesionit është përgjegjës për zhvillimin dhe përditësimin e standardeve të profesionit të fushës përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>3. Personat që ushtrojnë një profesion të rregulluar organizohen në një organ profesional.</p> <p>4. Organizimi dhe funksionimi i organit profesional bëhet sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>association or body.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>The competent body on the development of standards of a profession</b></p> <p>1. The mission of the competent body is the preservation of high standards in the formation and exercise of the regulated profession and public protection from profession misuse.</p> <p>2. The competent body on the development of standards of a profession is responsible for the development and update of standards of profession of the relevant field, according to the applicable laws.</p> <p>3. The persons practicing a regulated profession are organized in a professional body.</p> <p>4. Organization and functioning of the professional body is made according to the applicable laws.</p>	<p>profesionalnom udruženju</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Nadležni organ za razvoj standarda profesije</b></p> <p>1. Misija nadležnog organa je čuvanje visokih standarda u formulisanju i obavljanju regulisane profesije, kao i zaštita javnosti od lošeg bavljenja profesijom.</p> <p>2. Nadležni organ za razvoj standarda profesije je odgovoran za svakodnevni razvoj standarda profesije u relevantnoj oblast prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p>3. Lica koja se bave regulisanom profesijom se organizuju u jedan profesionalni organ.</p> <p>4. Organizovanje i funkcionisanje profesionalnog organa se vrši prema važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Përgjegjësitë e profesionistit</b></p> <p>1. Profesionisti ka për detyrë të:</p> <p>1.1. Të respektojë ligjet dhe kodin etik</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>The responsibilities of the professional</b></p> <p>1. The professional has an obligation to:</p> <p>1.1. Respect laws and professional ethic</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Odgovornosti profesije</b></p> <p>1. Profesionalac ima obaveze da:</p> <p>1.1. Poštuje zakone i etički kodeks</p>

<p>profesional;</p> <p>1.2. Të bëjë të njohur për publikun titullin profesional të tij;</p> <p>1.3. Të kujdeset për përditësimin e aftësive të veta profesionale;</p> <p>1.4. Të vërë në dijeni organin profesional përkatës për situata të mundshme të konfliktit të interesit, lidhur me shërbimin e kërkuar;</p> <p>1.5. Të vërë në dijeni përfituesin e shërbimit për anëtarësinë e tij në organin profesional përkatës, si dhe të japë të dhëna mbi përvojën e tij/saj profesionale.</p>	<p>code;</p> <p>1.2. Make public his/her professional title;</p> <p>1.3. Update regularly his/her professional skills;</p> <p>1.4. Make the relevant professional body aware of potential situations of conflict of interest, regarding to the required service;</p> <p>1.5. Make service beneficiaries aware of his/her membership in the relevant professional body, and give data on his/her professional experience.</p>	<p>profesije;</p> <p>1.2. Obelodani javnosti njegovo stručno zvanje;</p> <p>1.3. Ažurira njegove profesionalne sposobnosti;</p> <p>1.4. Da obavesti nadležnog organa o mogućim situacijama sukoba interesa, u pogledu zatražene usluge;</p> <p>1.5. Obavesti korisnike usluga o njegovom učlanjivanju u dotični profesionalni organ, kao i da daje podatke o njegovom/njenom profesionalnom iskustvu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Kodi etik profesional</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>The professional ethics code</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Kodeks profesionalne etike</b></p>
<p>1. Kodi etik profesional, përmbajtja e të cilit kuptohet lehtë nga pala e tretë, rregullon ushtrimin e veprimtarisë profesionale të çdo profesionisti.</p> <p>2. Kriteret dhe procedurat e hartimit të kodit etik profesional përcaktohen nga organi profesional i fushës përkatëse.</p> <p>3. Kodi etik profesional udhëhiqet nga këto parime:</p>	<p>1. The professional ethics code, the content of which is easily understood by a third party, regulates the practice of professional activity of each professional.</p> <p>2. The criteria and compilation procedures of any professional ethics code are defined by the professional body of the relevant field.</p> <p>3. The professional ethics code is guided by these principles:</p>	<p>1. Kodeks profesionalne etike, sadržaj koji treća strana lako shvata, reguliše bavljenje profesionalnom delatnošću svakog profesionalca.</p> <p>2. Kriterijumi i procedure izrade profesionalnog etičkog kodeksa se određuju od strane profesionalnog organa dotične oblasti.</p> <p>3. Kodeks profesionalne etike je upravlján sledećim principima:</p>

<p>3.1. Mbrojtja e interesave publike përmes ushtrimit korrekt të profesionit;</p> <p>3.2. Mbrojtja e besimit dhe e zgjedhjes së lirë nga përfituesi i shërbimit;</p> <p>3.3. Sigurimi i cilësisë së shërbimeve profesionale;</p> <p>3.4. Sigurimi i të dhënave të duhura për përmbajtjen dhe mënyrat e ushtrimit të shërbimeve profesionale.</p> <p>4. Kodi etik publikohet dhe përditësohet periodikisht nga organi kompetent përkatës.</p>	<p>3.1. Protection of public interests through proper exercise of the profession;</p> <p>3.2. Protection of beliefs and free choice by the service beneficiary;</p> <p>3.3. Quality assurance of professional services;</p> <p>3.4. Assurance of proper data for the maintenance and methods of exercising professional services.</p> <p>4. The ethics code is published and updated periodically by the relevant competent body.</p>	<p>3.1. Zaštita javnog interesa kroz pravilno obavljanje profesije;</p> <p>3.2. Zaštita uverenja i slobodnog izbora korisnika usluge;</p> <p>3.3. Osiguranje kvaliteta profesionalnih usluga;</p> <p>3.4. Osiguranje potrebnih podataka za održavanje i načine izvršavanja profesionalnih usluga.</p> <p>4. Etički kodeks ažurira periodično dotični nadležni organ.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Masat disiplinore</b></p> <p>1. Çdo profesionist, i cili shkel detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj, në ligje të veçanta që rregullojnë fushën e veprimtarisë së tij, apo në kodin etik profesional ndëshkohet me masa administrative.</p> <p>2. Llojet e masave administrative, autoriteti përgjegjës, procedurat e dhënies, të ankimit, parashkrimi apo shuarja e këtyre masave përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për themelimin e organit profesional në fushën përkatëse.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Disciplinary measures</b></p> <p>1. Any professional that violates the obligations set forth in this Law, in special laws that regulate its activity field, or in the professional ethics code is punished with administrative measures.</p> <p>2. The types of administrative disciplinary measures, responsible authority, award procedures, appeals, prescription or extinction of these measures are determined in accordance with the legislation in force for the establishment of the professional body in the relevant field.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Disciplinske mere</b></p> <p>1. Svaki profesionalac, koji krši obaveze određene ovim Zakonom, u specijalnim zakonima koji regulišu njegovu oblast delovanja, ili kodeks profesionalne etike kažnjen je administrativnim merama.</p> <p>2. Vrste administrativnih mera, odgovorna vlast, procedure izdavanja, žalbene procedure, predviđanje ili prestanak ovih mera se određuju prema važećim zakonodavstvom za osnivanje nadležnog organa u relevantoj oblasti.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Dispozitat kalimtare</b></p> <p>1. Ministri brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, do të nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.</p> <p>2. Dispozitat të cilat kanë implikime financiare mund të hyjnë në fuqi nga viti buxhetor 2016, po qe se krijohen dhe përmbushen kushtet financiare.</p> <p>3. Në rast të konfliktit mes dispozitave të këtij ligji dhe çfarëdo ligji të posaçëm përkitazi me provimin shtetëror dhe licencimin e profesionistëve, dispozitat e ligjit të posaçëm do të mbizotërojnë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Transitional provisions</b></p> <p>1. The Minister within six (6) months from entry into force of this Law will issue sub-legal acts for its implementation.</p> <p>2. Provisions which have financial implications can enter into force from the budgetary year 2016, if the financial conditions are created and met.</p> <p>3. In case of conflict between provisions of this law and any specific law regarding the state exam and licensing of professionals, provisions of the specific law will prevail.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Prelazne odredbe</b></p> <p>1. Ministar u roku od šest (6) meseci, od stupanja na snagu Zakona donosiće dotične podzakonske akte za njihovu primenu.</p> <p>2. Odredbe koje imaju finansijske posledice mogu stupati na snagu od budžetske godine 2016, ukoliko su stvoreni i ispunjeni finansijski uslovi.</p> <p>3. U slučaju konflikata odredbi ovoga zakona sa bilo kojim posebnim zakonom u vezi državnog ispita i licenciranje stručnjaka, odredbe posebnog zakona će prevladati.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Entry into force</b></p> <p>This Law enters into force fifteen (15) days after publication in the official gazette of the Republic of Kosova.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Chairman of the Assembly of the Republic of Kosova</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>